



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“MBROJTJE MJEDISI PYJOR”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

S4-IV-17

Tiranë, Prill 2017

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Mbrojtje Mjedisi Pyjor”			Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK	S4-IV-17
Qëllimi:	<p>Qëllimi i kualifikimit profesional “Mbrojtje Mjedisi Pyjor” niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë punonjës të nivelit profesional teknik i mesëm, të zhvillojë qasjen e individëve ndaj mbrojtjes së mjedisit përgatitjen e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e mjedisit pyjor. Zhvillimi, tek individi, i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe në një shkallë të gjerë njohurish dhe shprehish profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Mbrojtje Mjedisi Pyjor” të nivelit i katërt në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë përfunduar kualifikimin profesional “Pyje”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i Kualifikimit profesional “Mbrojtje Mjedisi Pyjor”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe suplementin përkatës të teknikut të mesëm në këtë fushë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky kualifikim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si teknik i mesëm i profilit pyjor për t’u punësuar në njësi ekonomike të tilla si: bashki, kompani private të menaxhimit dhe trajtimit të pyjeve, administratën e zonave të mbrojtura, inspektoratin e pyjeve dhe mjedisit, sektorin e emergjencave civile, organizatat mjedisore (OJF), etj.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Nuk ka			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Sipërmarrja dhe organizimi

- Të shpjegojë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj;
- Të shpjegojë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të shpjegojë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
- Të përshkruajnë aktivitetet e biznesit të kryera nga sipërmarrësit;
- Të përshkruajnë procesin e financimit nëpërmjet krijimit të planit të biznesit dhe analizën e burimeve të financimit;
- Të rendisë mjetet e punës dhe bazën materiale të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit pyjor;

Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm

- Të shpjegojë kuptimin për “mjedisin”, “mbrojtjen e mjedisit” dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të përshkruajë burimet kryesore të mjedisit jetësor;
- Të shpjegojë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor;
- Të përshkruajë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore;
- Të përshkruajë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të përshkruajë sistemet e menaxhimit të mjedisit;
- Të përshkruajë problemet mjedisore në mjedisin vendor;
- Të përshkruajë parimet për menaxhimin e mjedisit pyjor;

Silvoekologjia (Ekologjia pyjore)

- Të shpjegojë rëndësinë e faktorëve ekologjik në jetën dhe zhvillimin e pyjeve dhe kullotave;
- Të shpjegojë ndikimin e faktorit klimatik në jetën e grumbullit pyjor;
- Të shpjegojë rolin e ekosistemit pyjor në cilësinë e ujërave;
- Të shpjegojë rolin e pyllit në cilësitë e tokës dhe ndikimin në fenomenin e erozionit;
- Të shpjegojë rolin e pyllit mbi ndryshimet klimatike;
- Të përcaktojë llojet e humusit dhe karakteristikat e tyre;
- Të përcaktojë fazat dhe mënyrat e ripërtëritjes së pyllit;
- Të përcaktojë e dallojë etapat nga fazat e zhvillimit të pyllit;
- Të përshkruajë tipet e vegjetacionit pyjor sipas zonave fitoklimatike;
- Të përshkruajë ndikimet e ndërhyrjeve me trajtime në mjedisin pyjor;
- Të përshkruajë formacionet e pyjeve malore dhe në sipërfaqe të pjerrëta, si dhe masat e veçanta për zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre;
- Të përshkruajë gjendjen reale të pyjeve të vendit tonë, grumbujt e degraduar shkaqet dhe masat kryesore teknike dhe organizative për përmirësim të gjendjes;

Mbarështim pyjesh dhe kullote.

- Të përshkruajë parimet bazë të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave;
- Të përshkruajë parimet kryesore për organizimin e territorit në ekonominë pyjore, kullosore, në ngastra dhe nën/ngastra;
- Të përshkruajë kushtet stacionale dhe grumbullin pyjor;
- Të shpjegojë shenjat kufitare që përdoren në ndarjen territoriale, në ekonominë pyjore, kullosore, në ngastra dhe nën/nënngastra;
- Të shpjegojë shenjat kufitare që përdoren në ndarjen territoriale në hartë;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe vlerën e kullotave natyrore, llojshmërinë e florës dhe vlerat ushqyese të barit ë kullotave;
- Të listojë llojet e bimëve një dhe shumë vjeçare të kullotave;
- Të klasifikojë kullotat sipas kohës së përdorimit dhe përbërjes së bimësisë;
- Të përshkruajë masat për rritjen e prodhimit të kullotave;
- Të përshkruajë praktikën tradicionale të mbrojtjes e përdorimit të pyllit dhe kullotës nga familjet apo dhe në nivel fshati;
- Të përshkruajë rëndësinë e pjesëmarrjes së komunitetit vendor në përgatitjen dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për pyjet dhe kullotat;

Shfrytëzimi ekologjik i pyjeve

- Të përshkruajë ndikimin e punimeve inxhinierike të ndërtimit të rrugëve auto, teleferikëve, ngrehinave, të shesheve të depozitimit në mjedisin pyjor (sedimentimi në rrjedhjet ujore, erozioni tokës, rrëshqitjet, prishja e korridoreve ekologjike të faunës së egër, etj.);
- Të përshkruajë ndikimin e operacioneve të shfrytëzimit të lëndës drusore në mjedisin pyjor (dëmtimi filizërisë, dëmtimi i tokës dhe rrjedhjeve ujore, infektimi nga speciet e dëmshme);
- Të përshkruajë ndikimet e operacioneve për nxjerrjen e materialeve drusore në mjedisin pyjor (ulja vlerës së lëndës drusore, dëmtimi i tokës, rrjedhjeve ujore);
- Të përshkruajë mekanizmat kryesore të shfrytëzimit të pyllit me pak ndikime në mjedis (traktor me motoargano, teleferikët, lugjet plastike);
- Të përshkruajë sistemet e transportit ajror të materialit drusor;
- Të përshkruajë masat zbutëse gjatë asortimit dhe transportit të brendshëm me krahë, mjete dhe mekanizma;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse në vendet e depozitimit dhe sheshet e ngarkimit të materialit drusor;
- Të përshkruajnë mënyrat e ruajtjes së materialit drusor në pikat tranzite të materialit drusor;
- Të përshkruajë masat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të njerëzve, mjeteve dhe mekanizmave; masat për mbrojtjen nga zjarret në të gjitha fazat e procesit teknologjik dhe transportit të largët të materialit drusor;

Pyllëzimi dhe mbrojtja e tokës

- Të përshkruajë fazat e zbatimit të një projekti pyllëzimi;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse paraprake gjatë pyllëzimit dhe pas tij si dhe masat për ndalimin e kullotjes;
- Të shpjegojë zgjedhjen e llojeve të bimësisë në bazë të tipit të pyllit ekzistues, studimit të mjedisit dhe eksperimentit;

- Të listojë llojet e drurëve që mund të përdoren për pyllëzime;
- Të shpjegojë formulat e përzierjes së llojeve të drurëve pyjorë në pyllëzime;
- Të përshkruajë skemat e pyllëzimeve artificiale, skemat kryesore të pyllëzimeve të grumbujve që do të kenë funksion kryesor mbrojtjen e tokës;
- Të shpjegojë mënyrat e punimit të tokës në objektet e pyllëzimit, kryesisht tek grumbujt me funksion mbrojtjen e tokës;
- Të përshkruajë standardet dhe teknikat e mbjelljes së fidanëve;
- Të përshkruajë punimet për mirëmbajtjen e kulturave pyjore në pyllëzimet me funksion mbrojtjen e tokës;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe qëllimet e pyllëzimeve në ranishte bregdetare;
- Të përshkruajë pyllëzimet në tokat e rrëshqitshme dhe në pjesët e sipërme të baseneve të zhveshura;
- Të përshkruajë punimet për mbjelljet anës rrugëve dhe veshjen e skarpateve me bimësi
- Të përshkruajë brezat pyjor me funksion mbrojtje në tokat bujqësore, mjediset e banimit dhe fermat blegtorale;

Mbrojtje natyre e planifikim territori

- Të shpjegojë qëllimin dhe objektivat e mbrojtjes së natyrës;
- Të shpjegojë format e ndryshme të përdorimit të tokës;
- Të shpjegojë masat për mbrojtjen e faunës dhe bimëve të kërcënuara;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe përdorimit të territorit pa cenuar vlerat e peizazhit natyror;
- Të përshkruajë faktorët abiotike që ndikojnë në jetën e mjedisit pyjor;
- Të përshkruajë masat parandaluese për zjarret në mjedisin pyjor;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të zjarrit;
- Të përshkruajë masat të shuarjen e tyre me mjete rrethanore dhe vegla dore;
- Të shpjegojë faktorët që ndikojnë në shfaqjen e zjarreve në pyje e kullota;
- Të përshkruajë masat pas zjarrit, vlerësimi i dëmit dhe mundësia për ripërtëritje;
- Të dallojë ngastrat më të ekspozuara për prerje të paligjshme dhe dëmtime nga faktorët atmosferike në zonë;
- Të dallojë zonat që rrezikohen të dëmtohen nga kullotja, shtigjet dhe rrugët e lëvizjes e blegtorisë në mjedisin ku ndalohet kullotja;
- Të përshkruajë veprimet që kryen në rastin e një kundërvajtjeje në pyll/kullotë dhe në rastin kur është kryer dëmtimi;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit, në vendngjarje të dokumentacionin të kërkuar në rast e konstatimit të dëmit;
- Të listojë fazat e ngritjes dhe funksionimit të sistemit të vrojtimit sinjalizimit për zjarret në pyje dhe kullota;

Energjia dhe mjedisi pyjor

- Të përshkruajë format e energjisë;
- Të shpjegojë rolin e pyllit si burim biomase dhe energjie të rinovueshme;
- Të përshkruajë rolin e pyllit në reduktimin e gazeve serë;
- Të përshkruajë ndikimin e formave të ndryshme të energjisë në ndryshimet klimatike;

Biodiversiteti

- Të përshkruajë diversitetin e specieve në mjedisin pyjor;
- Të shpjegojë lidhjen midis diversitetit të specieve dhe qëndrueshmërisë së ekosistemit pyjor;
- Të listojë speciet e rrezikuara sipas statusit të tyre;
- Të përshkruajë rrjetin ekologjik të zonave të mbrojtura dhe kategoritë sipas klasifikimeve ndërkombëtare;
- Të analizojë faktorët që ndikojnë në vlerat e biodiversitetit të një mjedisi pyjor;
- Të shpjegojë të dhënat kryesore (tabela, grafikë) për biodiversitetin në një rast studimi të një mjedisi pyjor;

Ligjshmëria mbi mjedisin

- Të listojë dispozitat ligjore mbi trajtimin e pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore dhe faunës;
- Të përshkruajë legjislacionin mbi ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit;
- Të përshkruajë legjislacionin mbi peshkimin, akuakulturën dhe ushtrimin e gjuetisë;
- Të përshkruajë dokumentacionin e veprimtarisë kontrolluese të inspektoriatit pyjor;
- Të listojë konventat kryesore ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;
- Të përshkruajë legjislacionin e punës dhe kodin e etikës në punë;

Ekosistemi pyjor

- Të shpjegojë rëndësinë e cikleve biogjeokimike në jetesën e organizmave në mjedisin pyjor;
- Të shpjegojë rrjedhën e energjisë dhe lëndëve ushqyese në mjedisin pyjor;
- Të përshkruajë ndërveprimet e organizmave në shoqërimet brenda mjedisit pyjor;
- Të shpjegojë sesi kryhet vetërregullimi në një ekosistem pyjor;
- Të shpjegojë proceset e përzgjedhjes natyrore dhe përshtatjes në një mjedis pyjor;
- Të përshkruajë diversitetin e specieve në një popullatë pyjore;
- Të identifikojë faktorët që ndikojnë në rritjen e përbërësve të mjedisit pyjor;
- Të shpjegojë normat limit në kapacitetin mbajtës të një ekosistemi pyjor dhe kullosor;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Sipërmarrja dhe organizimi

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
- Të plotësojë dokumentacionin e lëvizjes së mallrave e shërbimeve, si dhe veprimeve kryesore me bankën;
- Të plotësojë regjistra të ditore të punës;
- Të plotësojë akt-marrje të punimeve dhe hartimin e situacioneve;
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës;
- Të hartojë një plan të thjeshtë për një biznes që mund të zhvillohet me bazë në pyje dhe kullota;
- Të përzgjedhë mjetet e punës dhe bazën materiale të nevojshme;

Mjedisin dhe zhvillimi i qëndrueshëm

- Të zbatohet punimet për rehabilitimin e një mjedisi të keq menaxhuar;
- Të zbatohet punimet e parashikuara në planin e menaxhimit;
- Të hartohet raporte të vlerësimit të indikatorëve evropian për menaxhimin e qëndrueshëm;
- Të zbatohet kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të përzgjedhë sistemit më të përshtatshme në menaxhimin e mjedisit;
- Të dallojë problemet mjedisore në nivel lokal;
- Të zbatohet parimet për menaxhimin e qëndrueshëm të mjediseve pyjore dhe kullotore;
- Të planifikojë dhe realizojë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit lokal;

Ekologjia pyjore

- Të identifikojë dhe llogarisë disa nga treguesit klimatik që ndikojnë në zhvillimin e drurëve dhe pyllit;
- Të dallojë tipet tokës e të humusit në masivin pyjor;
- Të zbatohet punimet për ripërtëritjen e grumbujve pyjore
- Të kryejë rilevimin e bimëve treguese në një grumbull pyjor;
- Të vlerësojë ndikimet që trajtimet silvoteknike kanë në pyll;
- Të përcaktojë mënyrat e ripërtëritjes;
- Të dallojë një ekosistem të degraduar (eroduar) nga një ekosistem optimal;
- Të dallojë e vlerësojë llojet e humusit në ekosistemet pyjore;
- Të dallojë mënyrat e ripërtëritjes së pyllit;
- Të dallojë etapat nga fazat e zhvillimit të pyllit;
- Të identifikojë tipet e vegjetacionit pyjor sipas zonave fitoklimatike;
- Të dallojë ndikimet e trajtimeve të ndryshme në mjedisin pyjor;

Mbarështim pyjesh dhe kullote

- Të realizojë përshkrimin parcelar të një njësie ekonomike;
- Të hartohet një raport për ndikimet e shfrytëzimit pyjor në grumbullin pyjor;
- Të kryejë vendosjen e shenjave të ndarjes parcelare në terren;
- Të inventarizojë bimët në një kullotë;
- Të llogarisë prodhimtarinë dhe kapacitetin mbajtës të një kullotë;
- Të zbatohet punimet për rritjen e prodhimtarisë së një kullotë;
- Të përcaktojë metodat e mbarështimit;
- Të ndajë ekonominë pyjore në parcela dhe nën/parcela;
- Të përcaktojë rrugët e rritjes së efektivitetit të kullotave;
- Të përcaktojë llojet e bimëve një dhe shumëvjeçare;
- Të zbërthejë dhe zbatohet etapat e zhvillimit të një plani mbarështimi;
- Të reflektojë në hartë ndryshimet brenda një ekonomie pyjore;
- Të evidentojë kushtet stacionale dhe grumbullin pyjor;
- Të identifikojë shenjat kufitare që përdoren në ndarjen territoriale në ekonominë pyjore;
- Të evidentojë llojet e bimëve një dhe shumë vjeçare të kullotave;

Shfrytëzimi ekologjik i pyjeve

- Të vlerësojë ndikimet e trajtimeve të ndryshme që zbatohen në mjedisin pyjor;
- Të përdorë disa nga mekanizmat e shfrytëzimit me impakte minimale në mjedis;

- Të zbatohet disa nga punimet në montimin e teleferikëve dhe hapjen e rrugëve auto;
- Të përdorë mjetet dhe mekanizmat për transportin e brendshëm në pyje;
- Të përcaktojë vendet e depozitimit për depozitimin e materialit drusor;
- Të zgjedhë transportin e brendshëm në një sipërfaqe pyjore;
- Të mbrojtë mjedisin nga shfrytëzimi pyjor dhe gjatë punës në parcela;
- Të zbatohet masa zbutëse në ndikimin ndaj mjedisit, gjatë fazave të prerjeve ripërtëritëse;
- Të zbatohet masat mbrojtëse në sheshet e depozitimit dhe skelat e ngarkimit të materialit drusorë;
- Të zbatohet masat e sigurimit teknik, të mbrojtjes në punë dhe të mbrojtjes nga zjarret në të gjitha fazat e procesit teknologjik dhe transportit të largët të materialit drusorë;
- Të përdorë, mjetet e mbrojtjes nga zjarri që ju vihen ë dispozicion sipas rregullave;

Pyllëzime dhe mbrojtja e tokës

- Të zbatohet punimet përgatitore për pyllëzimin e një sipërfaqeje pyjore;
- Të piketojë dhe të zbatohet punimet e mbjelljes në terren;
- Të kryejë shërbimet kulturore për fidanët në objektet e pyllëzimit;
- Të ndërtojë skemat e pyllëzimeve artificiale;
- Të projektojë punimet në mbjelljen e fidanëve në anët e rrugëve ,në zonat e gjelbërta, tokat e rrëshqitshme etj.,;
- Të përzgjedhë llojet e drurëve që mund të përdoren në vendin tonë;
- Të identifikojë llojet pyjore që përdoren kryesisht për pyllëzim;
- Të identifikojë llojet e drurëve që mund të përdoren për pyllëzime sipas zonave fito-klimatike në vendin tonë;

Mbrojtje natyre e planifikim territori

- Të dallojë format e ndryshme të përdorimit të tokës;
- Të dallojë tipet e peizazheve pyjore;
- Të organizojë në terren dhe të përcaktojë masat parandaluese për zjarret në mjedisin pyjor;
- Të ndërhyjë me mjete efektive në çdo fazë të zhvillimit të zjarrit;
- Të përdorë mjetet rrethore dhe vegla dore në çdo rast zjarri;
- Të kontrollojë pastrimin me zjarr të kullotave;
- Të bëjë vlerësimin e demit në natyrë dhe vlerë të shkaktuar nga zjarri apo dhe prerjet abuzive në ngastrat pyjore dhe kullosore;
- Të kryejë veprimet e duhura në rast kundravajte;
- Të plotësojë në vendngjarje dokumentacionin e kërkuar në çdo rast procedimi e konstatim demi;
- Të ngrejë sistemin e vrojtimit-sinjalizimit për sëmundjet e zjarret në pyje dhe kullota në nivel ekonomie pyjore/ kullosore;
- Të zbatohet teknikat dhe metodologjitë më të përshtatshme për raste sëmundje dhe dëmtuesi në mjedisin pyjor/kullosor;
- Të kryejë intervista dhe të marrë në konsideratë kërkesat dhe rekomandimet nga komunitetet vendore për mbrojtjen e pyjeve;
- Të marrë pjesë aktive në çdo rast projekti dhe planifikimi në ndërhyrjet në mjedisin pyjor;

Energjia dhe mjedisi pyjor

- Të kryejë llogaritje të volumit të biomasës për prodhim energjie sipas një metodologjie apo grumbullim të dhënash që kërkohen;
- Të llogarisë volumin e mbetjeve për prodhim energjie nga biomasa pyjore;
- Të llogarisë sasinë e CO2 të sekuestruar nga një ekosistem pyjor;
- Të vlerësojë si burim energjie mbetjet në pyll nga punimet e shfrytëzimit dhe trajtimet silvikulturore, si dhe nga dëmtimet e agjenteve atmosferike;

Biodiversiteti

- Të identifikojë diversitetin dhe llojet e specieve në mjedisin pyjor;
- Të plotësojë të dhënat kryesore (tabela, grafikë) për biodiversitetin në një rast studimi të një mjedisi pyjor;
- Të identifikojë speciet e rrezikuara;
- Të kryejë një inventar të thjeshtë të florës për të vlerësuar nivelin e biodiversitetit;
- Të kryejë llogaritjen e treguesve të dominancës dhe abandonancës së specieve në një grumbull pyjor;

Ligjshmëria mbi mjedisin

- Të zbatojë dispozitat ligjore mbi trajtimin e pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore dhe faunës;
- Të respektojë legjislacionin mbi ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit;
- Të respektojë legjislacionin mbi peshkimin, akuakulturën dhe ushtrimin e gjuetisë;
- Të plotësojë dokumentacionin e veprimtarisë kontrolluese të inspektoriatit pyjor;
- Të respektojë konventat kryesore ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;
- Të zbatojë legjislacionin e punës dhe kodin e etikës në punë;

Ekosistemi pyjor

- Të evidentojë bashkëshoqërimet pyjore në një ekosistem pyjor;
- Të ngrejë një sipërfaqe prove si pjesë e rrjetit të monitorimit;
- Të identifikojë në terren një ekosistem të degraduar dhe një ekosistem me kapacitet optimal;
- Të llogarisë biomasën në një njësi të ekosistemit pyjor;
- Të llogarisë normat limit në kapacitetin mbajtës të një ekosistemi pyjor dhe kullosor;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij/saj dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij/saj personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;

- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.